

Dembelët e "Hasan Prishtinës"

Monitorohen Filozofiku, Juridiku dhe Ekonomiku

Ndërkohë që marrin pagat më të larta në nivel vendi nga paraja publike, rezultatet e monitorimit tregojnë se profesorët e UP-së nuk i përmbahen detyrave dhe përgjegjësive në universitet. Nga 1177 ligjërata të monitoruara, 218 nuk janë mbajtur.

Përtaci

Një njeri përtac s'punonte aspak.
Puna më e vogël i bëhej farmak.

Një herë s'kish ushqim, bukë s'i jepnin tjetër,
shkoi pra në fushë, te një dardhë e vjetër.

Dardha kishte kokrra, të mëdha gërcak,
të ëmbla sheqer, pjekur për merak.

Po përtaci ishte njeri për çudi:
përtoi t'i shkundte, në hije u shtri.

Hoqi dhe kapelën, pranë vetes e la,
"Bini këtu brenda, o ju dardha!" - tha.

Priste kokrra dardhe nga degët e saja,
kur një dardhë e madhe u shkëput nga maja
dhe përtacit tonë në hundë i ra,
thirri fort përtaci: "Obobo, ç'hata!".

Mark Krasniqi



HYRJA

Si pasojë e ankesave të studentëve dhe raportimeve të mediave për Universitetin e Prishtinës, ORCA ka vendosur t'i hulumtojë disa aspekte të mbarëvajtjes së mësimdhënies në universitet.

ORCA ka monitoruar tri Fakultetet me numrin më të madh të studentëve në UP: Fakultetin Filozofik, Fakultetin Ekonomik dhe Fakultetin Juridik.

Gjatë muajit prill, ORCA ka monitoruar mbajtjen e konsultimeve sipas orareve zyrtare të këtyre fakulteteve¹. Nga 86 profesorë të monitoruar nga Fakulteti Juridik, Ekonomik dhe Filozofik, 34 kanë munguar në 100% të termineve të caktuara për konsultime.

Përgjatë muajit maj është vazhduar me monitorimin e mbarëvajtjes së ligjëratave sipas orareve zyrtare të këtyre fakulteteve të shpallura nga Universiteti i Prishtinës. Ligjëratat janë detyrim që del nga Statuti i UP-së, neni 139, në të cilin thuhet: "Kalendari i studimeve nxirret nga Senati më së voni deri më 31 maj dhe përmban orarin e ligjëratave (ligjëratat, ushtrimet, seminarët, kolokviumet), kushtet dhe afatet e provimit".

Hulumtimi vë në pah mosrespektimin e orarit të punës nga një pjesë e stafit akademik. Sipas të gjeturave të hulumtimit, nga 1177 ligjërata sa janë monitoruar në tri fakultetet e përfshira në hulumtim, 218 apo 18,5% prej

tyre nuk janë mbajtur për shkak të mosprezencës së profesorëve.

Po ashtu, gjatë muajit qershor ORCA ka monitoruar mbarëvajtjen e provimeve, ku janë monitoruar nga 20 provime për Fakultetin Ekonomik, Filozofik dhe Juridik; në total 60. Nga këto 60 provime, 4 nuk janë mbajtur fare, 14 janë mbajtur nga asistentët ose profesorë të tjerë, dhe 15 kanë filluar me vonesë më shumë se 15 minuta.

Për ta parë edhe nga perspektiva e studentëve situatën rreth mbarëvajtjes së mësimit: konsultimeve, ligjëratave dhe provimeve, ORCA ka administruar një pyetësor të 92 studentëve të tri fakulteteve me pyetje që kanë të bëjnë me konsultimet, ligjëratat, provimet si dhe disa pyetje të përgjithshme për cilësinë e Universitetit të Prishtinës si institucion i arsimit të lartë. Rezultatet e pyetësorëve tregojnë se përshtypja e studentëve është se në universitet mbretëron një gjendje relativisht e dobët e organizimit. Nga 92 respondentë, 74 kanë thënë që ligjëratat mbahen me rregull sipas orarit zyrtar. Nga 92 respondentë, 76 kanë thënë që ka ndodhur që asistenti ka ligjëruar në vend të profesorit çka përbën shkelje të Statutit të UP-së. Nga 92 respondentë, 37 kanë thënë që ekziston mjaft hapësirë/salla për të zhvilluar provimet, ndërsa 55 kanë thënë që nuk ka mjaft hapësirë/salla për t'i zhvilluar provimet.

1 "“Hasan Prishtina” slackers”, http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2017/05/Raporti-i-Monitorimit_Interactive.pdf

METODOLOGJIA E MONITORIMIT TË LIGJËRATAVE DHE PROVIMEVE

OBJEKTI I HULUMTIMIT

Përzgjedhja e objekteve të hulumtimit (Fakultetit Filozofik, Ekonomik dhe Juridik) është bërë në bazë të numrit të studentëve dhe ngarkesës që ato kanë, parë nga raporti i numrit të profesorëve dhe studentëve. Po ashtu është marrë parasysh që një numër i konsiderueshëm i profesorëve të këtyre fakulteteve kanë angazhime të tjera publike.

Janë monitoruar vetëm profesorët të cilëve u ka figuruar emri në orarin zyrtar të ligjëratave të shpallur nga Universiteti apo të cilët kanë CV të publikuar në faqen e fakultetit përkatës.

Sa i përket monitorimit të provimeve, provimet janë përzgjedhur në mënyrë të qëllimshme, nga 20 për secilin fakultet, në atë mënyrë që të përfshihen të gjitha departamentet/programet, dhe vitet e studimeve.

KOHA E MONITORIMI

Monitorimi i ligjëratave është bërë përgjatë muajit prill dhe maj të vitit 2017, nga data 24 prill deri në datën 19 maj.

Monitorimi i provimeve është bërë përgjatë muajit qershor, nga data 1 qershor deri më 21 qershor.

METODA E HULUMTIMIT

Janë caktuar monitorues për secilin fakultet të monitoruar të cilët kanë mbajtur evidencë individuale për të gjithë stafin akademik me grada profesoriale (profesor asistent, profesor i asocuar apo profesor i rregullt). Është monitoruar puna e 116 profesorëve. Ky numër përfshin vetëm ata që kanë pasur ligjërata të planifikuara për t'u mbajtur sipas orarit të shpallur në formë

elektronike në uebfaqen zyrtare të Universitetit të Prishtinës apo në tabelat zyrtare të fakulteteve përkatëse.

Sa i përket provimeve janë monitoruar sipas orarit zyrtar të shpallur në formë elektronike në uebfaqet zyrtare të fakulteteve, ose të shpallura në tabelat e shpalljeve të fakulteteve përkatëse.

MBËSHTETJA LIGJORE

Neni 139 pika 4 i Statutit të Universitetit të Prishtinës përcakton se "Kalendari i studimeve nxirret nga Senati më së voni deri më 31 maj dhe përmban orarin e ligjëratave (ligjëratat, ushtrimet, seminarët, kolokviumet), kushtet dhe afatet e provimit".

Vendimi i Këshillit Drejtues me Nr. 2/901 i datës 13 tetor 2016 përcakton që orari i punës në Universitetin e Prishtinës

për personelin akademik është 08:00 – 16:00.

Neni 8, pika 1.a e Kodit të Etikës të stafit akademik të Universitetit të Prishtinës thotë që "Dështimi për t'i përmbushur përgjegjësitë e mësimi, që përfshin: a. Mohimin arbitrar të qasjes në mësim;" dhe 1.b "Dështimin që t'u përmbahet, pa arsye legjitime, rregullave të fakultetit gjatë mësimdhënies, mbajtjen e orës, mbajtjen e orëve zyrtare apo mbajtjen e provimeve sipas orarit konsiderohen sjellje të papranueshme.

Neni 111 i Statutit trajton oraret e provimeve; pika 3 "Oraret e afateve të provimeve, ku janë të përfshira oraret ditorë, shpallen në fillim të vitit akademik", pika 4 "Oraret e provimeve do të përcaktohen në atë mënyrë që studenti të mos ketë më shumë se një provim në ditë", dhe pika 5 "Oraret e provimeve, pasi të jenë shpallur, janë detyruese si për pyetësin ashtu edhe për studentin".

Neni 113 i Statutit, pika 1 "Koha e paraqitjes së provimit do të fillojë jo më herët se 6 javë para përfundimit dhe jo më vonë se 8 ditë para fillimit të afatit të provimit", pika 2 "Orari i provimit duhet të shpallet jo më vonë se tri ditë para datës së provimit".

KUFIZIME METODOLOGJIKE NË MONITORIMIN E LIGJËRATAVE DHE PROVIMEVE

ORCA e ka pasur të pamundur ta vërtetojë mbajtjen e ligjëratave në orare apo salla të tjera që mund të kenë ndodhur si rezultat i marrëveshjes me studentë me mënyra joformale (grupe në Facebook) apo formale (përmes email-it), me qëllim zëvendësimin e ligjëratave të humbura. ORCA nuk paragjykon mundësinë e mbajtjes së ligjëratave në ndonjë orar apo sallë tjetër në mar-

rëveshje me studentët në rastet kur profesorët kanë munguar.

ORCA e ka pasur të pamundur të vërtetojë mbajtjen e provimeve në orare apo salla të tjera që mund të kenë ndodhur si rezultat i marrëveshjes me studentë me mënyra joformale (grupe në Facebook) apo formale (përmes email-it), me qëllim ndryshimin e datave të provimeve. ORCA nuk paragjykon mundësinë e mbajtjes së provimeve në ndonjë orar apo sallë tjetër në marrëveshje me studentët. Gjithashtu për rastet kur janë dy provime në të njëjtën kohë, ORCA nuk ka arritur të konfirmojë nëse këto dy provime janë të lëndëve zgjedhore, ku studenti i nënshtrohet vetëm njëres, meqenëse në orare zyrtare të provimeve nuk janë të cekura nëse janë lëndë obligative apo zgjedhore.

METODOLOGJIA E ADMINISTRIMIT TË PYETËSORËVE

PJESËMARRËSIT

Pjesëmarrësit në këtë hulumtim kanë qenë 92 studentë të Fakultetit Filozofik, Ekonomik dhe Juridik. 46 nga këta respondentë janë femra, 45 meshkuj, dhe një përgjigje mungon. Moshë e këtyre respondentëve është nga 18 deri 26 (mesatarja 20.34, DS=1.72). Respondentët janë studentë nga viti i parë deri në të katërt, ku 30 respondentë janë në vitin e parë, 34 janë në vitin e dytë, 21 janë në vitin e tretë, dhe shtatë janë në vitin e katërt.

30 respondentë janë nga Fakulteti Filozofik (katër nga departamenti i Antropologjisë, dy nga Arkeologjia, katër nga Filozofia, katër nga Historia, katër nga Psikologjia, tre nga Punë Sociale, pesë nga Shkencat Politike, dhe katër nga Sociolog-

jia). 32 respondentë janë nga Fakulteti Juridik. 30 respondentët e tjerë janë nga Fakulteti Ekonomik (dy nga Applied Economics and Management, tetë nga Banka, Financa dhe Kontabiliteti, tre nga Ekonomiksi, katër nga Kontabiliteti, gjashtë nga Marketingu, gjashtë nga Menaxhmenti dhe Informatika).

PROCEDURA

Pyetësorët janë administruar nga monitoruesit e ORCA në tre Fakultetet. Respondentët janë zgjedhur me mostër të qëllimshme, të shpërndarë në departamente, vite studimesh dhe gjini. Pyetësorët janë administruar në javën e katërt të majit. Kohëzgjatja për plotësimin e një pyetësori ka qenë rreth 15 minuta.

INSTRUMENTET

Pyetësori i përdorur për këtë hulumtim ka qenë i përbërë nga 18 pyetje ku është përfshirë vetë-raportim i studentëve për mbajtjen e ligjëratave, konsultimeve, mbarëvajtjen e provimeve, si dhe disa pyetje të përgjithshme për cilësinë e Universitetit të Prishtinës. Sipas Alfës së Cronbach-it, e cila mat vlefshmërinë dhe besueshmërinë e pyetësorit nga 0 deri në 1, pyetësori ka një besueshmëri prej 0.796; pra ai ka një besueshmëri të lartë.

REZULTATET E HULUMTIMIT

PËRMBLEDHJE REZULTATESH

Gjatë monitorimit të ligjëratave në muajin maj, ORCA ka evidentuar një seri problemesh në Universitetin e Prishtinës. Në tri fakultetet e monitoruara është evidentuar mosrespektimi i orarit të ligjëratave: ndërrim sallash dhe oraresh pa paralajmërim zyrtar.

ORCA ka evidentuar se në tri fakultetet e monitoruara ka bashkim grupesh jo vetëm të të njëjtit departament, por edhe të departamenteve të ndryshme për mbajtjen e ligjëratave nga i njëjti profesor. Në këtë mënyrë profesorët arrijnë të mbajnë dy ligjëratat të ndryshme brenda kohëzgjatjes së një ligjërate. ORCA nuk ka arritur të sigurojë evidencë lidhur me pagesën e kryer për këto raste, nëse profesorët që kanë bërë bashkime të tilla janë paguar për dy apo për një ligjëratë.

ORCA ka evidentuar se në një numër të lartë të ligjëratave të monitoru-

ara profesorët vonohen në ligjëratat mbi 15 minuta, vonesë kjo e cila zgjat deri në 30 minuta. Përpos kësaj, përgjatë hulumtimit është vërejtur edhe mosrespektimi i kohëzgjatjes së ligjëratave ashtu siç është e shpallur në orarin zyrtar të UP-së.

Këtë konstatim e mbështet po ashtu, Raporti i Auditimit për UP-në i vitit 2016 në të cilin thuhet: "Në tetë nga 97 mostrat e testuara, kemi vërejtur se profesorët nuk shënojnë fare orën dhe datën e mbajtjes së ligjëratës, e disa të tjerë shënojnë vetëm fillimin e orës së mbajtjes së ligjëratës."²

Kjo tregon se ka një vijimësi në praktika të tilla të keqpërdorimit me mbajtjen e ligjëratave dhe kohëzgjatjen e tyre.

Është vërejtur se në fakultetet e përfshira në hulumtim ekzistojnë po ashtu parregullsi ku ligjëratat nuk mbahen nga profesorët por nga asistentët. Këto raste nga ORCA janë shënu-

ar si mungesa të profesorëve, sepse sipas pikës 3 të nenit 178 të Statutit të Universitetit të Prishtinës: "Asistentët mbajnë orët e ushtrimeve në studimet bachelor dhe master. Përrjashtimisht asistenti që është rizgjedhur, në mungesë të profesorit për lëndën, mund të autorizohet për mbajtjen e ligjëratave të kufizuara në studimet bachelor me autorizimin e këshillit të njesisë akademike dhe nën mbikëqyrjen e një mësimdhënësi nga departamenti-katedra".

Rezultatet e pyetësorëve tregojnë një gjendje mesatarisht të dobët të organizimit të Universitetit të Prishtinës. Nga 92 respondentë, 74 kanë thënë që ligjëratat mbahen me rregull sipas orarit zyrtar, 17 kanë thënë që nuk mbahen me rregull dhe një është përgjigjur "nuk e di". Nga 92 respondentë, 76 kanë thënë që ka ndodhur që asistenti ka ligjëruar në vend të profesorit, dhe 16 kanë thënë që nuk ka ndod-

2 Raporti i Auditimit Për Raportin Financiar Vjetor Të Universitetit Të Prishtinës "Hasan Prishtina" Për Vitin E Përfunduar Më 31 Dhjetor 2016, Nr. i Dokumentit: 24.4.1-2016-08, link: http://www.zka-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_UP_2016_Shqip_144173.pdf

hur. Nga 92 respondentë, 37 kanë thënë që ekziston mjaft hapësirë/salla për të zhvilluar provimet, ndërsa 55 kanë thënë që nuk ka mjaft hapësirë/salla për provime.

Ndaj pyetjes "Në përgjithësi a jeni të kënaqur me cilësinë e Universitetit të Prishtinës", studentët e vitit të parë raportuan që janë të kënaqur 5 respondentë, mesatarisht të kënaqur 17 respondentë, dhe jo të kënaqur 5 respondentë. Studentët e vitit të dytë raportuan që janë të kënaqur 8 respondentë, mesatarisht të kënaqur 17 respondentë, dhe jo të kënaqur 9 respondentë. Studentët e vitit të tretë raportuan që janë të kënaqur 5 respondentë, mesatarisht të kënaqur 11 respondentë dhe jo të kënaqur 5 respondentë. Studentët e vitit të katërt raportu-

an që janë mesatarisht të kënaqur 5 respondentë dhe jo të kënaqur 2 respondentë.

Nga këto përgjigje nuk mund të nxirret një përfundim për relacionin e vitit të studimeve të studentëve me (pa)kënaqësinë e studentëve me shërbimin e UP-së si institucion i arsimit të lartë.

Numri i të kënaqurve me cilësinë e UP-së është 18, ndërsa ai i të pakënaqurve 21. Në një mostër prej 92 respondentëve kjo diferencë është e papërfillshme mirëpo ajo nuk korrespondon me rezultatet nga pyetja tjetër. Ndaj pyetjes "A është përdorur ndonjëherë gjuhë fyese, diskriminuese, seksiste, raciste ndaj juve ose kolegëve tjerë?", 22 respondentë janë përgjigjur me "Po". Nga këta 22 respondentë, tetë


janë femra. Nga 22 respondentët që janë përgjigjur me "Po", 11 janë nga Fakulteti Filozofik, shtatë janë nga Fakulteti Ekonomik, dhe katër janë nga Fakulteti Juridik.

Mospërputhja mes të qenët "të kënaqur" me cilësinë e UP-së dhe identifikimit të përdorimit të gjuhës fyese ndaj vetë respondentëve apo studentëve të tjerë në praninë e respondentëve nga profesorët, flet për një pritje të ndarë që kanë studentët për cilësinë e shërbimeve administrative të universitetit ndaj shërbimit që ofrojnë profesorët. 4 nga 18 studentet e kënaqur me punën e universitetit, janë përgjigjur me "Po" në pyetjen "A është përdorë ndonjëherë gjuhë fyese, diskriminuese, seksiste, raciste ndaj juve ose kolegëve tjerë?"

REZULTATET E HULUMTIMIT NGA FAKULTETI FILOZOFIK

Rezultatet e monitorimit të ligjëratave dhe konsultimeve:

Janë monitoruar 314 ligjërata të paracaktuara për t'u mbajtur nga 32 profesorë. 77 apo 24,5% të ligjëratave nuk janë mbajtur për shkak të mosprezencës së profesorëve të lëndëve përkatëse.



Pyetësi i ORCA-s gjithashtu ka përfshirë disa pyetje për perceptimet e studentëve për mbarevajtjen e ligjëratave dhe konsultimeve. Në pyetjen se a mbahen ligjëratat me rregull sipas orarit zyrtar, 17 nga respondentët janë përgjigjur me "Po", 13 janë përgjigjur me "Jo".

	Përqindja
Po	56.7
Jo	43.3

Tabela 1. A mbahen ligjëratat me rregull sipas orarit zyrtar?

Në pyetjen "A ka ndodhur ndonjëherë të mbajë ligjëratën asistenti në vend të profesorit, 20 janë përgjigjur me "Po" dhe 10 janë përgjigjur me "Jo".

	Përqindja
Po	66.7
Jo	33.3

Tabela 2. A ka ndodhur ndonjëherë të mbajë ligjëratën asistenti në vend të profesorit?

Ndaj pyetjes "A ndodhin shpesh ndërrime të orarit të ligjëratave dhe /apo sallave?", 16 respondentë janë përgjigjur me "Po", 13 janë përgjigjur me "Jo", dhe një përgjigje mungon.

Ndaj pyetjes "A vonohen profesorët në ligjërata dhe sa?", dy kanë thënë që "Nuk vonohen", 7 janë përgjigjur me "0-5 minuta", 13 janë përgjigjur me "5-15 minuta", dhe 8 janë përgjigjur me "mbi 15 minuta".

	Përqindja
Nuk vonohen	6.7
0-5 minuta	23.3
5-15 minuta	43.3
Mbi 15 minuta	26.7

Tabela 3. A vonohen profesorët në ligjërata dhe sa?

Në pyetjen "Si informoheni për oraret e konsultimeve", respondentët kanë ofruar më shumë se dy përgjigje në disa raste: 19 janë përgjigjur me "nga profesori", gjashtë janë përgjigjur me "Nga studentët", gjashtë janë përgjigjur me "Oraret e vendosura pranë zyrës", dy janë përgjigjur me "Facebook", dhe një përgjigje mungon.

Ndaj pyetjes "A mbahen me rregull konsultimet sipas orarit", 15 janë përgjigjur me "Po", tetë janë përgjigjur me "Jo", gjashtë janë përgjigjur me "Nuk e di", dhe një përgjigje mungon.

Ndaj pyetjes "Sa keni qasje dhe komunikim me profesorë (përgjigjen me email, konsultime)", nëntë janë përgjigjur me "Mjaftueshëm", 15 janë përgjigjur me "Mesatarisht", pesë janë përgjigjur me "Pamjaftueshëm", dhe një përgjigje mungon.

	Përqindja
Shumë mirë	30
Mesatarisht	50
Pamjaftueshëm	16.7
Mungon	3.3

Tabela 4. Sa keni qasje dhe komunikim me profesorë (përgjigjen me email, konsultime)?

Rezultatet e monitorimit të provimeve:

Janë monitoruar 20 provime, duke u bazuar në orarin zyrtar të provimeve të Fakultetit Filozofik të shpallura në Tabelën e Shpalljes më 2 qershor. Në këtë tabelë nuk figurojnë provimet e departamentit të Antropologjisë, rrjedhimisht ORCA nuk ka arritur të monitorojë provimet e këtij departamenti.

Nga 20 provime, dy provime nuk janë mbajtur fare, katër provime janë mbajtur nga asistentët ose profesorë të tjerë

(jo të lëndës).

Sa i përket parregullsive tjera, një provim ka filluar më herët se që është paraparë me orar zyrtar, shtatë provime kanë filluar pas 20 minutash vonesë, dhe një sallë provimesh ka ndryshuar në moment të fundit.

Duke u bazuar në Statutin e Universitetit të Prishtinës, Neni 111, pika 4: "Oraret e provimeve do të përcaktohen në atë mënyrë që studenti të mos ketë më shumë se një provim në ditë", ORCA ka analizuar orarin e provimeve sipas viteve për të parë nëse ka më shumë se një provim në ditë.

Departamenti i Psikologjisë	Departamenti i Sociologjisë	Departamenti i Historisë	Departamenti i Shkencave Politike	Departamenti i Filozofisë	Departamenti i Punës Sociale
Viti i parë: 20 qershor - 2 provime	Viti i dytë: 20 qershor - 2 provime	Viti i dytë: 12 qershor - 2 provime	Viti i dytë: 12 qershor - 2 provime 15 qershor - 2 provime	Nuk janë arritur të hulumtohen sepse në orar provimet nuk janë të ndara sipas viteve.	Nuk janë arritur të hulumtohen sepse në orar provimet nuk janë të ndara sipas viteve.
Viti i dytë: 22 qershor - 2 provime 13 qershor - 3 provime 16 qershor - 2 provime		Viti i tretë: 28 qershor - 2 provime	Viti i tretë: 28 qershor - 3 provime 29 qershor - 2 provime		
Viti i tretë: 16 qershor - 3 provime 22 qershor - 2 provime 28 qershor - 2 provime					

Tabela 5. Datat kur ka pasur më shumë se një provim brenda ditës, të ndara sipas viteve të studimeve.

ORCA ka përfshirë pyetje sa i përket provimeve në pyetësin e administruar te studentët. Ndaj pyetjes "A ekzis-

ton mjaft hapësirë/salla për të zhvilluar provimet?, 19 janë përgjigjur me "Po", 11 janë përgjigjur me "Jo".


	Përqindja
Po	63.3
Jo	36.7

Tabela 6. A ekziston mjaft hapësirë / salla për të zhvilluar provimet?

REZULTATET E HULUMTIMIT NGA FAKULTETI EKONOMIK

Rezultatet nga monitorimi i ligjëratave dhe konsultimeve:

Janë monitoruar 627 ligjërata të paracaktuara për t'u mbajtur nga 50 profesorë. 77 apo 11,64% prej tyre nuk janë mbajtur për shkak të mosprezencës së profesorëve të lëndëve përkatëse.



Pyetësi i ORCA-s gjithashtu ka përfshirë disa pyetje për perceptimet e studentëve për mbarëvajtjen e ligjëratave dhe konsultimeve. Ndaj pyetjes se a mbahen ligjëratat me rregull sipas orarit zyrtar, 26 nga respondentët janë përgjigjur me "Po", tre janë përgjigjur me "Jo" dhe një është përgjigjur me "Nuk e di".

	Përqindja
Po	86.7
Jo	10
Nuk e di	3.3

Tabela 1. A mbahen ligjëratat me rregull sipas orarit zyrtar?

Ndaj pyetjes "A ka ndodhur ndonjëherë të mbajë ligjëraten asistenti në vend të profesorit", 25 janë përgjigjur me "Po" dhe pesë janë përgjigjur me "Jo".

	Përqindja
Po	83.3
Jo	16.7

Tabela 2. A ka ndodhur ndonjëherë të mbajë ligjëraten asistenti në vend të profesorit?

Ndaj pyetjes "A ndodhin shpesh ndërime të orarit të ligjëratave dhe/apo sallave?", 12 respondentë janë përgjigjur me "Po", 16 janë përgjigjur me "Jo", dhe dy janë përgjigjur me "Nuk e di".

Ndaj pyetjes "A vonohen profesorët në ligjërata dhe sa?", 14 janë përgjigjur me "0-5 minuta", 14 janë përgjigjur me "5-15 minuta", dhe dy janë përgjigjur me "mbi 15 minuta".

	Përqindja
0-5 minuta	46.7
5-15 minuta	46.7
Mbi 15 minuta	6.7

Tabela 3. A vonohen profesorët në ligjërata dhe sa?

Ndaj pyetjes "Si informoheni për oraret e konsultimeve", respondentët kanë ofruar më shumë se dy përgjigje në disa raste: dy janë përgjigjur me "Në internet", 12 janë përgjigjur me "nga profesori", tre janë përgjigjur me "Nga studentët", 10 janë përgjigjur me "Oraret e vendosura pranë zyrës", një është përgjigjur me "Facebook", një është përgjigjur me "pas rezultateve të provimeve", katër janë përgjigjur me "Uebfaqe", dhe një nuk e ka specifikuar se ku.

Ndaj pyetjes "A mbahen me rregull konsultimet sipas orarit", 13 janë përgjigjur me "Po", 12 janë përgjigjur me "Jo", katër janë përgjigjur me "nuk e di", dhe një përgjigje mungon.

Ndaj pyetjes "Sa keni qasje dhe komunikim me profesorë (përgjigjen me email, konsultime)", shtatë janë përgjigjur me "Shumë mirë", 19 janë përgjigjur me "Mesatarisht", tre janë përgjigjur me "Pamjaftueshëm", dhe një është përgjigjur me "Nuk e di"

	Përqindja
Shumë mirë	23.3
Mesatarisht	63.3
Pamjaftueshëm	10
Nuk e di	3.3

Tabela 4. Sa keni qasje dhe komunikim me profesorë (përgjigjen me email, konsultime)?

Rezultatet nga monitorimi i provimeve:

Janë monitoruar 20 provime, duke u bazuar në orarin zyrtar të provimeve të Fakultetit Ekonomik të shpallur në uebfaqen zyrtare të Fakultetit Ekonomik dhe një folderi në Google Drive ku janë paraqitur oraret e të gjitha provimeve. Ky orar është shpallur më 30 maj.

Nga 20 provime, një provim nuk është mbajtur fare, pesë provime janë mbajtur nga asistentët ose profesorë të tjerë (jo të lëndës).

Sa i përket parregullsive tjera, katër provime kanë filluar pas 30-40 minutash vonesë, dhe një sallë provimesh ka ndryshuar në moment të fundit.

Duke u bazuar në Statutin e Universitetit të Prishtinës, Neni 111, pika 4: "Oraret e provimeve do të përcaktohen në atë mënyrë që studenti të mos ketë më shumë se një provim në ditë", ORCA ka analizuar orarin e provimeve sipas viteve për të parë nëse ka më shumë se një provim në ditë.

Departamenti i Marketingut	Departamenti Applied Economics and Management
Viti i dytë	Viti i dytë
14 qershor - 2 provime	29 qershor - 2 provime

Tabela 5. Datat kur ka pasur më shumë se një provim brenda ditës, të ndara sipas viteve të studimeve.

ORCA ka përfshirë pyetje sa i përket provimeve në pyetësorin e administruar të studentët. Ndaj pyetjes "A ekziston mjaft hapësirë/salla për të zhvilluar provimet?", 13 janë përgjigjur me "Po", 17 janë përgjigjur me "Jo".


	Përqindja
Po	43.3
Jo	56.7

Tabela 6. A ekziston mjaft hapësirë/salla për të zhvilluar provimet?

REZUTATET E HULUMTIMIT NGA FAKULTETI JURIDIK

Rezultatet e monitorimit të ligjëratave dhe konsultimeve:

Janë monitoruar 236 ligjërata të paracaktuara për t'u mbajtur nga 34 profesorë. 64 apo 27,11% prej tyre nuk janë mbajtur për shkak të mosprezencës së profesorëve të lëndëve përkatëse.



Pyetësi i ORCA-s gjithashtu ka përfshirë disa pyetje për perceptimet e studentëve për mbarevajtjen e ligjëratave dhe konsultimeve. Ndaj pyetjes "A mbahen ligjëratat me rregull sipas orarit zyrtar", 31 nga respondentët janë përgjigjur me "Po", një është përgjigjur me "Jo".

	Përqindja
Po	69.9
Jo	3.1

Tabela 1. A mbahen ligjëratat me rregull sipas orarit zyrtar?

Ndaj pyetjes "A ka ndodhur ndonjëherë të mbajë ligjëraten asistenti në vend të profesorit", 20 janë përgjigjur me "Po" dhe 10 janë përgjigjur me "Jo".

	Përqindja
Po	66.6
Jo	33.4

Tabela 2. A ka ndodhur ndonjëherë të mbajë ligjëraten asistenti në vend të profesorit?

Ndaj pyetjes "A ndodhin shpesh ndërime të orarit të ligjëratave dhe/apo sallave?", tetë respondentë janë përgjigjur me "Po", 23 janë përgjigjur me "Jo", dhe një është përgjigjur me "nuk e di".

Ndaj pyetjes "A vonohen profesorët në ligjërata dhe sa?", katër kanë thënë që "Nuk vonohen", 11 janë përgjigjur me "0-5 minuta", 14 janë përgjigjur me "5-15 minuta", dhe tre janë përgjigjur me "mbi 15 minuta".

	Përqindja
Nuk vonohen	12.6
0-5 minuta	34.4
5-15 minuta	43.8
Mbi 15 minuta	9.4

Tabela 3. A vonohen profesorët në ligjërata dhe sa?

Ndaj pyetjes "Si informoheni për oraret e konsultimeve", respondentët kanë ofruar më shumë se dy përgjigje në disa raste: një është përgjigjur me "Facebook", 18 janë përgjigjur me "nga profesori", shtatë janë përgjigjur me "nga studentët", tre janë përgjigjur me "oraret e vendosura pranë zyrës", dy janë përgjigjur me "në syllabus", dhe dy të tjerë kanë thënë që nuk kanë dijeni për orarin e konsultimeve.

Ndaj pyetjes "A mbahen me rregull konsultimet sipas orarit", 12 janë përgjigjur me "Po", 13 janë përgjigjur me "Jo", shtatë janë përgjigjur me "nuk e di".

Ndaj pyetjes "Sa keni qasje dhe komunikim me profesorë (përgjigjen me email, konsultime)", shtatë janë përgjigjur me "Shumë mirë", 17 janë përgjigjur me "Mesatarisht", tetë janë përgjigjur me "Pamjaftueshëm", dhe një përgjigje mungon.

	Përqindja
Shumë mirë	21.9
Mesatarisht	53.1
Pamjaftueshëm	25

Tabela 4. Sa keni qasje dhe komunikim me profesorë (përgjigjen me email, konsultime?).

Rezultatet nga monitorimi i provimeve:

Janë monitoruar 20 provime, duke u bazuar në orarin zyrtar të provimeve të Fakultetit Juridik të shpallur në Tabelën e Shpalljeve të fakultetit Juridik ku janë paraqitur oraret e të gjitha provimeve. Ky orar është shpallur më 1 qershor.

Nga 20 provime, një provim nuk është mbajtur fare, pesë provime janë mbajtur nga asistentët ose profesorë të tjerë (jo të lëndës).

Sa i përket parregullsive tjera, katër provime kanë filluar pas 15-40 minutash vonesë, një provim ka filluar 15 minu-

ta para orarit zyrtar, në një provim ku profesori është vonuar 20 minuta, studentët janë ankuar që ai e ka përfunduar provimin 10 minuta para përfundimit sipas orarit zyrtar, si dhe në dy provime studentët janë ndarë në dy grupe, ku njëri grup ka filluar provimin sipas orarit zyrtar, dhe grupi tjetër ka pritur një orë që t'i nënshtrohen provimit.

Duke u bazuar në Statutin e Universitetit të Prishtinës, Neni 111, pika 4, ku thuhet: "Oraret e provimeve do të përcaktohen në atë mënyrë që studenti të mos ketë më shumë se një provim në ditë", ORCA ka analizuar orarin e provimeve sipas viteve për të parë nëse ka më shumë se një provim në ditë.

Viti i parë	Viti i dytë	Viti i tretë	Viti i katërt	Moduli ndër-kombëtar
8 qershor - 3 provime	12 qershor - 2 provime	9 qershor - 2 provime	15 qershor - 2 provime	17 qershor - 2 provime
15 qershor - 3 provime	14 qershor - 4 provime	15 qershor - 2 provime	16 qershor - 3 provime	
	30 qershor - 2 provime	16 qershor - 5 provime	30 qershor - 2 provime	
		23 qershor - 3 provime		

Tabela 5. Datat kur ka pasur më shumë se një provim brenda ditës, të ndara sipas viteve të studimeve.

ORCA ka përfshirë pyetje sa i përket provimeve në pyetësorin e administruar te studentët. Ndaj pyetjes "A ekzis-

ton mjaft hapësirë/salla për të zhvilluar provimet?, pesë janë përgjigjur me "Po", 27 janë përgjigjur me "Jo".

	Përqindja
Po	15.6
Jo	84.4

Tabela 6. A ekziston mjaft hapësirë/salla për të zhvilluar provimet?

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

KONKLUZION

Profesorët e UP-së përveç pagave bazë kanë qasje edhe në shumë honorare për çështje të ndryshme që lidhen me punën e tyre të përditshme siç janë mbajtja e provimeve, mentorimet, pjesëmarrja në komisione.

REKOMANDIM

Organet menaxhuese të njësive akademike duhet të fillojnë procedurat për shqiptimin e masave dhe ndalesat e mëditjes apo pagesave të tjera të parapara me Rregulloren për të Ardhurat Personale.

KONKLUZION

Nuk ka kontroll efikas për mbajtjen e të gjitha ligjëratave nga profesorët.

REKOMANDIM

Menaxhmentet e fakulteteve duhet të sigurohen se oraret e ligjëratave respektohen përmes mekanizmave efikasë të cilët duhet të krijohen.

KONKLUZION

Nuk ekziston praktika e standardizuar e njoftimit për ndryshimin e orareve të ligjëratave, konsultimeve apo provimeve.

REKOMANDIM

Ndryshimet në orare të ligjëratave, konsultimeve apo provimeve duhet të shpallen zyrtarisht përmes një platforme online siç mund të jetë SEMS.

KONKLUZION

Vendimi i Këshillit Drejtues Nr. 2/901 që obligon profesorët të jenë në hapësirat e UP-së nga ora 8:00 deri në ora 16:00, nuk respektohet në masë të gjerë nga stafi akademik i UP-së.

REKOMANDIM

Të merren masa në heqjen e mëditjeve dhe ndëshkimin disiplinor ndaj profesorëve që nuk respektojnë vendin e punës dhe vendimmarrjen e hierarkisë institucionale.

KONKLUZION

Kalendari i studimeve nuk nxirret në kohë nga Senati dhe nuk përmban detajet e kërkuara me nenin 139 të Statutit të UP-së.

REKOMANDIM

Të zbatohen në tërësi Neni 139, pika 1, i Statutit të Universitetit të Prishtinës sipas të cilit: "Kalendari i studimeve nxirret nga Senati më së voni deri më 31 maj dhe përmban orarin e ligjëratave (ligjëratat, ushtrimet, seminarët, kolokviumet), kushtet dhe afatet e provimit".

KONKLUZION

Ligjëratat nuk mbahen në gjatësinë e termineve të parapara.

REKOMANDIM

Të krijohen mekanizma të korrektesisë së zbatimit të kontratave të punës me stafin akademik. Të krijohen mekanizma për respektimin e kohëzgjatjes së ligjëratave ashtu siç është e shpallur në orarin zyrtar nga Universiteti i Prishtinës dhe po ashtu të merren masa ndëshkimore për mosrespektimin e tyre.

KONKLuzion

Profesorët e angazhuar në lëndën e njëjtë në departamente të ndryshme, bashkojnë grupet për të mbajtur të njëjtën ligjëratë ndërkaq nuk është e qartë nëse paguhen për ligjëratën e mbajtur në dy grupe apo vetëm në njërin grup.

REKOMANDIM

Të ndalohet bashkimi i grupeve të ndryshme përveç në rastet kur prapa një bashkimi të mundshëm ekzistojnë qëllime të sqaruara akademike.

KONKLuzion

Faqet elektronike në fakultetet, departamentet dhe grupet e ndryshme nuk funksionojnë sipas një standardi të caktuar.

REKOMANDIM

Të standardizohen të gjitha faqet e fakulteteve dhe të përditësohen me informacione të reja. Të krijohet mundësia e marrjes së informatave të përditësuara nga SEMS dhe të shtyhen studentët për përdorim sa më të shpeshtë të tij.

ÇFARË ËSHTË ORCA?

Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim (ORCA) është krijuar në vitin 2016 në Prishtinë.

1. Organizata është themeluar me qëllim të:

- a. kryerjes së hulumtimeve dhe analizave për çështje të arsimit në Kosovë
- b. krijimit të një pasqyre për gjendjen e arsimit në Kosovë
- c. ofrimit të rekomandimeve për institucionet relevante për përmirësimin e gjendjes së arsimit në Kosovë.

2. Për t'i përmbushur qëllimet e saj, organizata do të ndër marrë, por nuk do të kufizohet vetëm në këto lloje të aktiviteteve:

- a. të hartojë hulumtime dhe dokumente tjera në të cilat analizohet gjendja në arsim në Kosovë
- b. të organizojë tryeza, diskutime publike, aktivitete demokratike për rritjen e vetëdijesimit qytetar lidhur me arsimin në Kosovë
- c. të organizojë takime me institucione relevante kombëtare e ndërkombëtare për çështjen e arsimit në Kosovë.

Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim - ORCA është organizatë që do t'i zhvillojë të dy aspektet e veprimit të OJQ-ve të parapara me ligjet e Kosovës. Një pjesë e madhe e punës do të bazohet në hulumtimin e botimeve në revista të dyshimta dhe në hulumtimin e rasteve të plagjiaturave.

Paralelisht, ORCA do të shtrihet në Universitetin e Prishtinës duke synuar krijimin e një mase kritike studentore dhe të profesorëve përmes organizimit të aktiviteteve me studentë dhe me stafin akademik për arritjen e qëllimeve të saj.

Pikëpamjet e shprehura në këtë raport nuk paraqesin domosdoshmërisht edhe pikëpamjet e KFOS

Ky raport u mbështet nga:



www.orca-ks.org
info@orca-ks.org

"Simon Shiroka", H-11, Nr. 8, 10000 Prishtina, Kosova